



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

**PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018
SESIONI I**

SKEMA E VLERËSIMIT

Lënda: Psikologji

Udhëzime të përgjithshme

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	C	D	D	B	B	A	C	D	B	C

Pyetjet me zhvillim

Pyetja 11 3 pikë

Model përgjigjeje:

- a)
- Bën të mundur të zbulohen lidhjet shkak-pasojë.
 - Eksperimenti është një situatë e tillë ku studiuesi ndryshon në mënyrë sistematike një ose më shumë ndryshore për të përcaktuar një ose më shumë ndryshime të cilat çojnë në ndryshime të një ose më shumë ndryshoreve të tjera.
 - Kur studiuesi vë re se ndryshimet në një ndryshore shkaktojnë në mënyrë të qëndrueshme ndryshime të një ndryshoreje tjetër, atëherë ai arrin në përfundimin se ndërmjet tyre ka një lidhje shkakësore.
- b) Kjo metodë funksionon me anë të elementeve të saj.
- hipoteza- është një mendim paraprak që shpreh një lidhje shkakësore ndërmjet një ose më shumë ndryshoreve që studiohen në eksperiment;
 - ndryshorja e varur- pritet të ndryshojë si pasojë e ndryshimeve që i bëhen ndryshores së pavarur;
 - ndryshorja e pavarur- ndryshon në mënyrë sistematike dhe me synim nga studiuesi, për të parë nëse ndryshimet e saj çojnë në ndryshime tek ndryshoret e tjera që studiohen;
 - grupi i eksperimentit- grupi i individëve ku ndryshohet ndryshorja e pavarur dhe maten ndryshimet te ndryshorja e varur;
 - grupi i kontrollit - grupi i individëve ku nuk ndryshohet ndryshorja e pavarur, po kur

- ndryshorja e varur matet po në të njëjtën mënyrë. Ky grup është i domosdoshëm. Ai përcakton me saktësi efektet e ndryshores së pavarur te ndryshorja e varur.
- 3 pikë** Nëse shkruan tre funksione **OSE** nëse shkruan tre aspekte të përmbajtjes **OSE** dy aspekte të përmbajtjes dhe një funksion **OSE** nëse shkruan një aspekt të përmbajtjes dhe dy funksione
- 2 pikë** Nëse shkruan dy aspekte të përmbajtjes **OSE** nëse shkruan dy funksione **OSE** nëse shkruan një aspekt të përmbajtjes dhe një funksion
- 1 pikë** Nëse shkruan një aspekt të përmbajtjes **OSE** nëse shkruan një funksion;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Studion marrëdhëniet ndërmjet faktorëve psikologjikë dhe sëmundjeve.
- Ajo vë në dukje se sëmundjet shkaktohen jo vetëm nga faktorë fizikë, por edhe nga besimet, qëndrimet dhe stili i jetës që bën një njeri.
- Zbulimet e studimeve psikologjike përdoren për të parandaluar sëmundjet si dhe për të rehabilituar njerëzit e sëmurë /Ata zhvillojnë trajnime për menaxhimin e stresit me grupe njerëzish në vendet e punës, ndihmojnë njerëz të veçantë që kanë problem diabetin, mbipeshën, duhanin, alkoolin, përdorimin e drogës, etj.
- Gjithashtu ata ndihmojnë njerëzit që të përballojnë dhimbjet akute, periodike dhe kronike (p.sh., dhimbjet e kokës, të shpinës etj.) duke përdorur teknika të ndryshme.

- 3 pikë** Nëse shkruan tre shpjegime;
- 2 pikë** Nëse shkruan dy shpjegime;
- 1 pikë** Nëse shkruan një shpjegim;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**4 pikë**

Model përgjigjeje:

a) lidhet me situatën e brendshme në trupin tonë, e cila shoqëron emocionin. Ne pikasim se jemi të emocionuar atëherë kur ndjejmë se situata e brendshme e trupit tonë ndryshon.

- ne mund të ndjejmë ndryshimin e punës së zemrës ndryshimin e furnizimit me gjak, djersitjen e pëllëmbëve. Ndjeshmëria fiziologjike nuk tregon gjithmonë se kemi emocion. Ne mund të vrapojmë e të na rrahë zemra, e të mos kemi emocion.

b) ka të bëjë me mënyrën se si e kuptojmë dhe interpretojmë një ngacmues ose një situatë.

- nëse në mes të natës ne dëgjojmë një zhurmë në murin e shtëpisë ku ndodhemi, këtë mund ta perceptojmë në mënyra të ndryshme. Kur zhurma perceptohet si një përpjekje e vjedhësve për të hyrë në shtëpi, atëherë një kuptim i tillë na bën që të ndjejmë frikë nga e papritura që mund të ndodhë. Ajo që ne mendojmë na bën që të emocionohemi.

- 4 pikë** Nëse shkruan dy përbërës dhe nga një shembull për secilin;
- OSE**
- 3 pikë** Nëse shkruan dy përbërës dhe një shembull për njërin prej tyre **OSE** nëse shkruan dy shembuj dhe një përbërës;
- 2 pikë** Nëse shkruan nga një shembull për secilin përbërës **OSE** nëse shkruan dy përbërës;
- 1 pikë** Nëse shkruan një përbërës **OSE** nëse shkruan një shembull;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Stresi është reagim që organizmi bën kur ndaj tij paraqitet kërkesa të cilave ai duhet t'u përshtatet. Reagimi është ndaj kërkesave që njeriu ia bën vetes ose që i bëhen nga mjedisi rrethues. Njeriu mund të mos jetë në gjendje t'u përshtatet atyre kërkesave, kështu që ai mund të përjetojë mirëqenie të kërcënuar.
- Stresi është një ngjarje e zakonshme e jetës. Në përjetojmë herë më shumë e herë më pak stres, në varësi të presioneve që ne na bëhen për të ndryshuar. Ne ndjekim rrugë të ndryshme për t'u përshtatur. Disa herë reagojmë në mënyrë të papërshtatshme.
- Kur përdorim rrugë të gabuara, disa herë ne arrijmë të reagojmë në mënyrën e duhur dhe kjo është një përshtatje e mirë. Herë të tjera arrijmë të veprojmë me mjaft kompetencë duke ia dalë në krye pa vështirësi për të arritur qëllimet tona.
- Reagimi që njeriu i stresuar bën, është një reagim i përgjithshëm dhe jo specifik. Masa e stresit që ndjejmë varet nga vlerësimi që i bëjmë ne situatës.
- Stresin e shkaktojnë stresorët, ngacmuesit të cilët bëjnë që ne të reagojmë në formën e stresit. Ata ndikojnë mbi organizmin në mënyrë lënduese qoftë në fizikun tonë, qoftë në psikologjinë tonë.

3 pikë Nëse shkruan tre aspekte;**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy aspekte;**1 pikë** Nëse shkruan një aspekt;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 15****3 pikë**

Model përgjigjeje:

Autori e sheh zhvillimin në këtë moshë si një proces që kryhet me pjesëmarrjen e të rriturve dhe brenda situatave që kërkojnë zgjidhje. Në të katër stadet ku kalon fëmija gjatë zhvillimit psikologjik, i duhet të zgjidhë një kontradiktë.

Stadi i parë: i besimit ose mosbesimit (0-1 vjeç). Ai ndodhet përballë situatave që i mundësojnë zhvillimin e besimit ose mosbesimit. Nëse kujdesi nuk është sistematik, nëse fëmija kërcënohet gjatë kujdesit që tregohet për të, nëse fëmijës nuk i ofrohet dashuri dhe ëmbëlsi, ky fëmijë do të zhvillojë mosbesim.

Stadi i dytë: autonomia ose turpi (1-3 vjeç). Fëmija në këtë stad ose do të bëjë gjëra vetë, ose do të presë t'i japin leje e ta mbrojnë. Prindërit mund ta ndihmojnë fëmijën duke ia mbështetur autonominë që fëmijët shfaqin dhe e kërkojnë.

Stadi i tretë: i iniciativës ose fajit (3-6 vjeç). Fëmijët zhvillojnë iniciativë për të përdorur në mënyra të reja motoriken e tyre, dhe mendjen. Nëse këto përpjekje janë shumë të kontrolluara ose të penguara, (sepse fëmijëve çfarë nuk u pjell mendja), fëmijët dënohen të zhvillojnë faj. Nëse këto përpjekje mbështeten fëmijët bëhen iniciatorë.

Stadi i katërt: i zellit ose inferioritetit (6-11, 12 vjeç). Në këtë periudhë fëmija zhvillohet pikërisht prej kënaqësisë dhe krenarisë që ndjen kur ndjehet realizator. Për çdo realizim ata pyesin të rriturit për të marrë vlerësimin e tyre. Nevoja bazë që ata ndjejnë është nevoja për vlerësim. Vlerësimi aktivizon kënaqësinë dhe krenarinë.

3 pikë Nëse shkruan tre stade;**2 pikë** Nëse shkruan dy stade;**1 pikë** Nëse shkruan një stad;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- herë ndihen superfuqi fizike me shëndet të hekurt, mjaft rezistentë e të shpejtë, e herë janë delikatë, lodhen e sëmuren shpejt;
- shpesh ndjehen seksualisht të pjekur, por nga ana tjetër ata vetë dhe shoqëria ka frikë nga energjia e tyre seksuale;
- Nga njëra anë ata e quajnë veten të pagabueshëm, nga ana tjetër, nuk kanë eksperiencën e duhur dhe bëjnë "mufka";
- Nga njëra anë kanë një vlerësim të shquar personal, nga ana tjetër "të tjerët nuk ua varin";
- Nga njëra anë ata kanë një moral puritan dhe janë krenarë për këtë, nga ana tjetër ata shohin se jeta "shpërblen" ata me moral të dyshimtë;
- Nga njëra anë ata janë në gjendje të zgjidhin detyra komplekse intelektuale, nga ana tjetër atyre nuk u besohen as detyra elementare, etj.

- 3 pikë** Nëse shkruan tre arsye;
2 pikë Nëse shkruan dy arsye;
1 pikë Nëse shkruan një arsye;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Të mësuarit është çdo ndryshim relativisht i qëndrueshëm në sjellje që shkaktohet nga përvoja e njeriut në mjedisin e tij;
- Ai ndodh si nga përvoja e drejtpërdrejtë, kur merr vetë pjesë në një ndodhi, ashtu edhe nga përvoja të tërthorta, ku nuk merr pjesë në një ndodhi, por e vëzhgon atë;
- Ndryshimet që ndodhin në sjellje si pasojë e përvojës, mund të jenë me pasojë pozitive ose negative;
- Të mësuarit nuk ka të bëjë me ndryshime që shkaktohen nga njeriu nga maturimi;
- Të mësuarit luan një rol aktiv në gjithçka që njeriu bën.

- 3 pikë** Nëse shkruan tre elemente;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy elemente;
1 pikë Nëse shkruan një element;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **3 pikë**

Model përgjigjeje:

Normalizon veprimtarinë e valëve alfa në tru, pas 1-2 minuta (janë valët e trurit në kushte qetësie) ul:

- ritmet e rrahjes së zemrës;
- ritmet e rrahjes së frymëmarrjes (4-6 për minutë);
- konsumin e oksigjenit nga organizmi;
- presionin e lartë të gjakut (dy meditime në ditë e normalizojnë presionin e lartë të gjakut);
- tensionin muskular.

3 pikë Nëse shkruan tre efekte;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy efekte;

1 pikë Nëse shkruan një efekt;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19

2 pikë

Model përgjigjeje:

- është sistemi logjik,/ realist e/racional i personalitetit./ Funkzioni i egos është të plotësojë dëshirat e idit, /por këtë ajo nuk e ka të lehtë, pasi superegoja përmban rregulla./ Parimi sipas të cilit funksionon egoja, është ai i realizimit të së mundshmes. /Egoja është përgjithësisht e vetëdijshme dhe pjesërisht e pavetëdijshme.
- sistemi moral i personalitetit, /të gjitha rregullat dhe ndalimet që kemi marrë nga prindërit, shoqëria e madhe të cilat, po t'i shkelim, ndjejmë faj. /Ajo përbëhet gjithashtu nga ideali. Të gjitha sjelljet për të cilat ne vlerësohemi e shpërblehemi ne duam t'i ribëjmë, për të fituar kënaqësi e shpërblim. /Ajo është edhe e vetëdijshme, edhe e pavetëdijshme.

2 pikë Nëse shkruan nga një tipar për secilën kërkesë ;

1 pikë Nëse shkruan një tipar vetëm për një të kërkesë;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20

3 pikë

Model përgjigjeje:

- Çrregullimet e diagnostikuara për herë të parë në foshnjëri, fëmijëri dhe adoleshencë/ (vonesa mendore, çrregullimet e të nxënës, sjellje shkatërruese).
- Deliret, dementia dhe çrregullime të tjera kognitive /turbullimi i ndërgjegjes.
- Çrregullimet mendore të lidhura me një situatë të përgjithshme shëndetësore, (deliret prej temperaturës së lartë).
- Vonesa mendore, çrregullimet e të nxënës, sjellja shkatërruese.
- Çrregullime që lidhen me përdorimin e substancave, / varësitë nga alkooli dhe drogat e tjera.
- Skizofrenia dhe çrregullimet e tjera psikotike, / deziluzionet.
- Çrregullimet e gjendjeve shpirtërore /depresioni.
- Çrregullimet e ankthit /paniku.
- Çrregullimet somatoforme/ astma,/ ekzemat.
- Çrregullimet e artificialitetit/simulimet.
- Çrregullimet seksuale dhe ato të idenditetit gjinor/ parafilitë.
- Çrregullimet e të ngrënit/anoreksia/ bulimia.
- Çrregullimet e gjumit /pagjumësi/ tmerri në gjumë/ përshtatjes/sindroma e Stokholmit/.
- Çrregullimet e personalitetit /personaliteti paranojak, /antisocial.

3 pikë Nëse shkruan tri sjellje;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy sjellje;

1 pikë Nëse shkruan një sjellje;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.